



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 11.08.2025
Numër Protokolli: 5368/2025

A.nr.1246/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtar, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1246/2025, të datës 27.06.2025, të parashtruar nga ankuesi A.P, kundër organit të punësimit: Agjencia Kosovare për Krahassim dhe Verifikim të Pronës, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me 11.08.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.1246/2025 e datës 27.06.2025, e parashtruar nga ankuesi, A.P.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, A.P (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi) më datë 27.06.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 4416/2025 të regjistruar nën shenjën A.nr.1246/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit të datës 04.06.2025 për shpalljen e kandidatit fitues për pozitën “Udhëheqës i Divizionit të Transportit”, të shpallur sipas Konkursit me numër Reference RN00017582, nga Agjencia Kosovare për Krahassim dhe Verifikim të Pronës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 14.07.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia Kosovare për Krahassim dhe Verifikim të Pronës, (ndërsa kjo e fundit më datë 22.07.2025, ka dërguar përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) duke ju referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë ka gjetur se ankesa e parashtruar nga ankuesi me datë 27.06.2025 është e palejuar, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit konstatoi se Agjencia Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës, më datë 07.04.2025 ka shpallur konkursin me numër reference RN00017582, për pozitën e Kategorisë së Ulët Drejtuese “Udhëheqës i Divizionit të Transportit”, me afat aplikimi nga data 08.04.2025 deri më 07.05.2025.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës rezulton se në konkursin përkatës të punësimit kanë aplikuar gjithsejtë njëzet (20) kandidatë, ndërsa prej tyre kriteret e konkursit i kanë plotësuar dhe kanë hyrë në listë të ngushtë dymbëdhjetë (12) kandidatë, mirëpo në mesin e tyre nuk rezulton se ankuesi ka aplikuar në procedurën përkatëse të rekrutimit, për faktin se emri i të njëjtit nuk figuron në listën e kandidatëve të aprovuar apo atyre të refuzuar.

Tutje, Njësia e Burimeve Njerëzore e Agjencisë Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës, me datë 04.06.2025, ka publikuar Njoftimin për renditjen përfundimtare, nga i cili njoftim rezulton se kandidati A.S me gjithsejtë 89.6 pikë të arritura nga kjo procedurë rekrutimi, është shpallur kandidat fitues për pozitën e punës Udhëheqës i Divizionit të Transportit.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundër njoftimit të lartë theksuar pretendon se procesi i rekrutimit është i paligjshëm sepse organi i punësimit ende nuk e ka përfunduar procesin e ristrukturimit, pasi që me Vendimin A.nr/51/2025 të KPMSHCK është anuluar vendimi Nr.13/2024 i AKKVP-së dhe pika e raportit të ristrukturimit Ref.Nr.01809/2024 në lidhje me propozimin e tij, duke theksuar po ashtu se pozita e shpallur përmban një pjesë të detyrave të pozitës Udhëheqës i Administratës, e cila është shuar tani më. Andaj, i njëjti kërkon anulimin e konkursit përkatës.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmërinë e ankesës iu referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 27 paragrafi 3 ku përcaktohet se: 3. *Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhëniet e punës në shërbimin civil*; nenit 44 paragrafit 10, i cili përcakton se: 10. *Kandidatët/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative*. si dhe dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 14 ku përcaktohet se “*Palë në procedurën administrative mund të jetë çdo person fizik, person juridik apo grup personash me një interes të përbashkët: 1.1. me kërkesë të të cilit organi publik ka filluar procedura administrative; 1.2. ndaj të cilit ka filluar procedura administrative apo të cilit rezultati i procedurës administrative mund t’i cenojë të drejtat apo interesat juridike. 2. Palë në procedurën administrative janë, gjithashtu, dhe mbrojtësit e interesave publike të autorizuar me ligj të veçantë, si dhe mbrojtësit e interesave kolektive apo të interesave të gjera të publikut, nëse këto interesa mund të cenohen nga rezultati i procedurës administrative*”, si dhe nenit 124 paragrafi 1 të të njëjtit ligj me të cilin parashihet se: *Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim, dhe si rrjedhojë referuar dispozitave përkatëse ligjore*, Kolegji i Këshillit, konstaton se organi përkatës i punësimit në rastin konkret, me rastin e zhvillimit të procedurës së rekrutimit me numër Reference RN00017582 si dhe publikimin e Njoftimit të datës 04.06.2025, për shpalljen e kandidati fitues për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Transportit, ankuesit nuk i ka cenuar ndonjë të drejtë apo interes juridik lidhur me marrëdhënien e tij të punës, për faktin se i njëjti nuk ka marrë pjesë fare në këtë procedurë rekrutimi, andaj i njëjti nuk ka legjitimitetin e palës në këtë çështje juridiko-administrative dhe rrjedhimisht në mungesë të legjitimitetit të palës ankesa A.nr.1246/2025 është e

palejuar në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kështu që, për sa më sipër, Kolegji konstaton se në rrethanat e rastit konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore për pranueshmërinë e ankesës në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 ndërlidhur me nenin 125 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe se duke u mbështetur në dispozitat e nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi që të hedhë poshtë ankesën si të palejueshme, siç është përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1246/2025

Atdhe GASHI
BAJRAKTARI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit A.P;
- Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës; si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.